



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02/21/22
Datë: 01.09.2022

Në bazë të nenit 12.2 paragrafi d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr: 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 22.1 paragrafi 4) të Statutit të Komunës së Junikut dhe nenit 16 paragrafi 3, të Rregullores së Punës së Kuvendit të Komunës së Junikut , **Kuvendi i Komunës së Junikut** në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 30.08.2022 nxjerrë:

V E N D I M

për fillimin e procedurave për plotësim – ndryshim të Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në teritorin e komunës së Junikut

- I. Me këtë vendim fillohet procedura për plotësim – ndryshim të **Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në teritorin e komunës së Junikut.**
- II. Qëllimi i nxjerrjes dhe miratimi i kesaj Rregulloreje me plotesim – ndryshime , sipas keti vendimi është organizimi dhe bashkëpunimi i Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urban brenda teritorit të komunës së Junikut në ushtrimin e aktiviteteve që janë te percaktuara me ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe Statutin e Komunës së Junikut
- III. Bartëse e hartimit të Rregullores nga pika I. E këtij vendimi është Drejtoria për Administratë e Komunës së Junikut.
- IV. Bartësja e hartimit të Rregullores është e obliguar që rregulloren ta hartojë në afatet ligjore .

- V. Autorizohet kryetari i komunës së Junikut që pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi të emëroj Grupin e punës për plotësim – ndryshim të rregullores nga pika I. E këtij vendimi.
- VI. Rregullorja duhet të vihet në shqyrtim publik dhe komente. Paraqitja e rregullores në shqyrtim publik dhe koha për dhënien e shqyrtimeve dhe komenteve do të shpallen në ueb faqen e Komunës së Junikut.
- VII. Pas hartimit të rregullores me plotësim – ndryshime i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.
- VIII. Mjetet financiare për hartimin e plotësimit – ndryshimit të rregullores sigurohen nga buxheti i Komunës së Junikut.
- IX. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohen të gjitha dispozitat logjore me anën e të cilave kjo fushë ka qenë e rregulluar.
- X. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset kryetari i Komunës së Junikut respektivisht Drejtoria për Administratë e Komunës së Junikut.
- XI. Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

1. MAPL;
2. Zyra e Kryetarit;
3. Drejtoria për Administratë;
4. Shërbimi i kuvendit të komunës;
5. Arkivi i Komunës.

Kuvendi i Komunës së Junikut
z. Shpejtim Gacaleri

Kryesues

